



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.229/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Gyltene Sylejmnnani dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vodusur përkitazi me ankesën e organizatës BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 18.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**PRANOHET** si e bazuar ankesa e organizatës BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj i shqiptohet dënim i më gjobë, në shumë prej 1,200.00 (*njëmijedyqind*) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënrim të përmbarimit**.

### A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 17.10.2017 nga organizata BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal të Ferizajt, Burim Karameta nga radhët e LDK-së, në një foto të publikuar në faqen e tij në Facebook, ka përdor fëmijë me qëllime të fushatës zgjedhore. Me këtë rast, parashtruesi i ankesës thekson se është shkelur neni 5.2 i Rregullës Zgjedhore nr.13/2013 të KQZ-së.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur një fotografi në lidhje me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë të datës 18.10.2017, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), thekson se fotografia e bashkangjitur ankesës është fotografi familjare dhe vetë porosia në fotografi ndërlidhet me familjen. Më tej, thekson se ka kërkuar që të largohet nga rrjeti social Facebook, dhe e njëjta është larguar. Subjekti politik LDK, kërkon që ankesa të hidhet si e pa bazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoj shkresat lëndës konform dispozitës së nenit 117 paragrafi 2 i LZP-së, konstatoj se :

## Ankesa është e bazuar

Paneli nga fotografia e ofruar si provë nga parashtruesi i ankesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka vërtetuar se Burim Karameta, kandidat për Anëtar të Komunës së Ferizajt, nga radhët e subjektit politik LDK, ka bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, nga fakti se, kandidati në fjalë në foton e publikuar, e cila përmban elemente të fushatës zgjedhore, ka përdor një fëmijë.

Nga dëshmitë e sipërcituara paneli në mënyrë të sigurt dhe të padyshimtë, ka vërtetuar se nga subjekti politik LDK, me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, janë bërë shkeljet e Kodit të Mirësjelljes për Subjekte Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, nga fakti se, foto e publikuar me fëmijë përbanë element të fushatës zgjedhore, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 5.2 të Rregullës Zgjedhore nr. 13/2013 të KQZ-së e cila përcakton: “*Në fushatën e zgjedhjeve të asnjë subjekti politik të certifikuar nuk mund të përfshihen personat që nuk i kanë mbushur 18 vjet*”.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rr Ethanat për rastin: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalët, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarjen e subjekti politik në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se LDK, ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marr subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur më fushatën zgjedhore. Po ashtu si rr Ethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e tij ka mohuar shkeljen e supozuar. Ndërmarrja e masave përmirësuese ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi. Paneli po ashtu vlerësoi, se dënim i shqiptuar ndaj subjektit në fjalë do të ndikon që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c), nenit 117.2 dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhë Parashtresa

ZL.Anr.229/2017 me datë 18.10.2017 P



Kryesuesi i Panelit

Adnan Konushevci

*Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së*